




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, [ëëë.gjilani-komuna.org](http://ee.gjilani-komuna.org); e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 56 paragrafi 2 dhe 6 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 23.01.2013, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 30.01.2013, miraton këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E ORARIT TË MBAJTJES SË MBLEDHJEVE TË
RREGULLTA TË KUVENDIT DHE KOMITETEVE TË KK-GJILAN PËR
VITIN KALENDARIK 2013

I

Me këtë vendim aprovohet orari i mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit dhe Komiteteve të KK-Gjilan për vitin kalendarik 2013.

II

Ndryshimi i datave të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës mund të bëhet vetëm me vendim të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, ndërsa Kryesuesi i Komitetit mund të vendos për ndryshimin e datës së mbajtjes së mbledhjes së Komitetit në pajtim me anëtarët e Komitetit dhe Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren në çdo kohë.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Orari i mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit dhe Komiteteve të KK-Gjilan për vitin kalendarik 2013.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16-10496
Gjilan, më 30.01.2013

Kuvendi i Komunës,

Izmi Zeka, Kryesues